



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
I SANKSIONEVE

Data: 11 Maj 2021

Nr: 69

VENDIM

PËR MOSPRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 45, PARAQITUR
NË KQZ NË DATËN 09.05.2021

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 11.05.2021, me pjesëmarrjen e:

Illirjan RUSMALI - Relator
Elvin LAKO - Anëtar
Elvis ÇEFA - Anëtar
Koli BELE - Anëtar
Ledio BRAHO - Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Subjekti zgjedhor koalicioni “ABEOK”;

OBJEKT: Shqyrtimi i kërkesës ankimore nr. 45, paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve datë 09.05.2021.

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129, 130 dhe 131 të “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenet 17 dhe 18 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator.

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,



VËREN:

Subjekti zgjedhor koalicioni 'ABEOK' ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesë ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 45 regj., datë 09.05.2021.

Objekti i kësaj kërkesë është "Detyrimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vënien në dispozicion vendimin e tij për votimin nga jashtë shtetit të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë në zgjedhjet e datës 25.04.2021 për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë".

Në kërkesën e depozituar prej tyre, subjekti ankues parashtron se i është drejtuar KSHZ-së për pajisjen me vendimin e tij për votimit nga jashtë shtetit të qytetarëve të Shqipërisë, dhe deri në datë 09.05.2021, KQZ ende nuk i ka kthyer një përgjigje zyrtare.

Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) vëren se në thelb, objekti i kërkesës ankimore nr. 45, është kërkesë për informacion. Si e tillë, kjo kërkesë bie në sferën dhe nën administrimin e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Në bazë të nenit 3 të këtij ligji, *Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik (...) Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.*

Procedura që duhet ndjekur nga subjekti ankues për marrjen e informacionit të kërkuar parashikohet në Kreun III të këtij ligji.

Sipas informacioneve të marra nga administrata e KQZ-së, KAS konstaton se subjektit ankues i është kthyer një përgjigje me shkresën nr. 3276/1 prot., datë 07.04.2021, ku i është sqaruar se për këtë vendim që kërkohet prej tyre, është përgatitur një draft, i cili është akoma në proces konsultimi me partitë politike. Pra, nuk ka patur ende një vendimmarrje nga ana e KSHZ-së.

Nëse kjo përgjigje e dhënë nga ana e KQZ-së nuk është në përputhje me kërkesat e ligjit "Për të drejtën e informimit", atëherë subjekti ankues mund të shfrytëzojë mjetet ligjore që parashikon Kreu VI i këtij ligji, dhe jo duke paraqitur ankim pranë KAS.

Për sa më sipër, KAS arrin në përfundimin se kjo kërkesë është jashtë rrethit të kompetencave të këtij Komisioni të cilat listohen në nenin 21 të Kodit Zgjedhor, pra nuk plotëson kriterin e kërkuar nga neni 18, pika 1, shkronja "a" e Vendimit të Komisionit Rregullator nr. 3, datë 06.11.2020 "Për miratimin e Rregullores për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve".



PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve mbështetur në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17, pika 3, shkronja “b” e 18, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve” të Komisionit Rregullator,

V E N D O S I:

1. Mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 45, datë 09.05.2021, të paraqitur nga subjekti zgjedhor koalicioni ‘ABEOK’;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjan RUSMALI - Relator

Elvin LAKO - Anëtar

Elvis ÇEFA - Anëtar

Koli BELE - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar

